



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

DREJTORIA E SHËRBIMEVE NDIHMËSAKADEMIKE ADMINISTRATIVE
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR



UNIVERSITETI I
GJIROKASTRËS
Universiteti "Eqrem Çabej"



UNIVERSITÀ
DEL SALENTO

Nr. 442 Prot.

Gjirokastrë, më 25.03.2024

MIRATOI

Prof. dr. Bektash MEMA

RECTOR



Lënda: Thirrje për bursë studimi për studentë në kuadër të Programit "Erasmus +" për komponentin KA171 *International Credit Mobility*.

Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë në bashkëpunim me Universitetin Salento në Itali në kuadër të Programit "Erasmus+" për komponentin KA1, fton të gjithë studentët e UGJ-së të aplikojnë për bursë mobiliteti për studim.

Mobiliteti përfshin:

- Shkëmbimin për studentët e programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë.
- Kohëzgjatja: 5 muaj
- Numri i kuotave: 2
- Periudha e mobilitetit: Semestri i vjeshtës së vitit akademik 2024-2025
- Bursa: 850 Euro/muaj
- Shpenzime udhëtimi: 180 Euro. Shpenzimet e udhëtimit përlogariten në bazë të largësisë sipas linkut:

https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/distance-calculator_en

Kriteret për aplikantët:

- Të jenë studentë "Bachelor" (përfshihen studentët që janë në vitin e parë në periudhën e mobilitetit), ose "Master" në UGJ.
 - Të jenë studentë, të cilët nuk e kanë përbushur periudhën e lejuar të realizimit të mobilitetit brenda një cikli studimi (prej 12 muajsh në total).
 - Të jenë studentë në programet e studimit sipas kodit ISCED "023"
- a) Të përcaktohen programet e studimit (bachelor dhe/ose master)

- Njohja e gjuhës angleze minimalisht në nivelin B1/ Njohja e gjuhës italiane minimalisht në nivelin B1.

Kriteret e përzgjedhjes:

Studentët do të përzgjidhen në bazë të skemës së miratuar në rregulloren “Për Implementimin e Marrëveshjeve Ndërinstitucionale në Kuadër të Programit “Erasmus+” KA107 International Credit Mobility”, sipas kriterëve të mëposhtme:

- Merita akademike.
 - Kompetenca gjuhësore.
- Në rast të kandidatëve me pikë të barabarta:
- Prioritet do tu jepet studentëve që u përkasin grupeve me diversitete sociale ekonomike, gjinore, racore, ngjyre, aftësi të veçanta, etj.
 - Barazia gjinore (aty ku është e mundur, të përzgjidhen kandidatë të barabartë në numër për nga gjinia).
 - Prioritet do t’u jepet studentëve që nuk kanë përfituar më parë nga programi Erasmus+ KA1.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Letër motivimi në anglisht
- Kopje e dokumentit identifikues / pasaportë
- Vërtetim studenti
- Transkript notash
- Çertifikatë që vërteton njohjen e gjuhës së huaj. Përfshihen studentët e programit të gjuhës angleze
- Dokument që vërteton që studenti u përket grupeve me diversitete sociale ekonomike, gjinore, racore, ngjyre, aftësi të veçanta, nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike ose bursë nga shteti etj, (nëse e dispononi)

Dorëzimi i dokumentave të aplikimit kryhet në një nga mënyrat e mëposhtme:

- Elektronikisht (të skanuara në formatin pdf) në adresat:
iro@uogj.edu.al
- Dorazi pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor

Shënim: Studentët janë të lutur përpara dorëzimit të aplikimit të konsultohen me përgjegjës të departamentit, nëse aplikimi i tyre është i përshatshëm mbështetur në katalogun e kurseve sipas linkut si më poshtë: <https://international.unisalento.it/mobility/course-catalogue>

Afati i fundit i aplikimit është 29/03/2024.

Procedura e përzgjedhjes:

- UGJ ngre një komision *ad-hoc*, i cili do t’i rendisë kandidatët në bazë të skemës së pikëzimit si dhe kriterëve të thirrjes.
- Kandidatët fitues do të njoftohen në adresën e tyre elektronike.
- Kandidatët aplikues kanë të drejtën e ankimit kundër vendimit të komisionit *ad-hoc* pranë Rektorit brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit.
- Në përfundim të afatit të ankimit, SMJKSH përcjell listën e studentëve të nominuar pranë universitetit pritës.
- Studentët e përzgjedhur do të kontaktohen prej universitetit pritës për të vazhduar më tej me procedurat e nevojshme.

Përpara fillimit të mobilitetit studentët fitues plotësojnë një dokument të quajtur *Learning Agreement* (Marrëveshje që vendoset midis studentit që aplikon, universitetit të origjinës si dhe universitetit pritës, në të cilën paracaktohen kurset me kreditet përkatëse sipas kriterit të numrit minimal të krediteve që studenti do të ndjekë gjatë semestrit në universitetin pritës, të cilat do t'i njihen në përfundim të tij dhe në vijim të studimeve në universitetin e origjinës).

KUJDES! Studenti, i cili do të kryejë gjatë një semestri mobilitetin në universitetin pritës, duhet të zgjedhë lëndë ekuivalente/të ngjashme me ato që do të zhvillonte në UGJ në po atë semestër. Kredite të pazgjedhura nga studentët që aplikojnë për mobilitet, për shkak të ndryshimeve midis programeve të studimit të UGJ-së dhe atyre të universitetit pritës, mbeten pjesë e detyrimeve akademike të programit të studimit që ndjek studenti aplikant, të cilat ai/ajo duhet t'i shlyejë sipas rregulloreve përkatëse të UGJ-së.

Më shumë informacion mbi universitetin pritës dhe katalogun e kurseve në gjuhë të huaj i gjeni në link-et:

<https://international.unisalento.it/>

<https://international.unisalento.it/mobility/course-catalogue>

Për më shumë informacion rreth skemës së mobilitetit dhe mënyrës së aplikimit mund të kontaktoni me:

- Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor (iro@uogj.edu.al).

Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë ju uron suksese!

Përgjegjëse e Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor

Irma Gjolleshi